



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 234, dt.17.11.2015

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren e miratuar me vendim të KKR nr. 75, dt.03.04.2015, “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licencave të ushtrimit të profesionit të restauratorit” në mbledhjen e datës 17.11.2015, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, pasi shqyrtoi kërkesën për pajisje me licencë në fushën e restaurimit për shoqërinë e ndërtimit “**Besta**” sh.p.k, me drejtues teknik restaurator ark. *Maksim Mitrojorgji*, me licensë personale profesionale në zbatim, R.P. 50,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “*Besta*” sh.p.k, me drejtues ligjor z. *Robert Zyka* për pajisje me licencë në fushën e restaurimit për kategorinë:
CZ: “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi”.
 2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, miratimin e kërkesës për pajisje me licencë restaurimi për shoqërinë “*Besta*” sh.p.k, për kategorinë:
CZ: “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi” me drejtues teknik restaurator ark. *Maksim Mitrojorgji*.
 3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI